

[Printo]

[Google Translate]

VENDIM**Nr.436, datë 28.4.2010**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1634, DATË 17.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË MËNYRËS SË MBËSHTETJES FINANCIARE, PËR RUAJTJEN E REZERVËS GJENETIKE TË RACËS AUTOKTONE TË BUAJVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 3 e 4 të nenit 58 të ligjit nr.9426, datë 6.10.2005 "Për mbarështimin e blegtorisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1634, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat "b" e "c" të pikës 1, në tabelën e pagesave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

Numërtimi, emërtimi për ruajtje për pjellje për remont

"b. Për buajt (M) 30 000 lekë;

c. për remontin 20 000 lekë.".

2. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

- Shkronja "b" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b. Pagesa për ruajtjen e buallit të jepet në fund të 6-mujorit të parë të vitit kalendarik, pas verifikimit të tij si ndërzyes në librin e ndërzim-pjelljeve të fermës së buajve.".

- Shkronja "ç" shfuqizohet.

- Shkronja "d" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"d. Pagesa për remontin femër jepet vetëm për mushkoret e moshës 16-18 muaj në fermat që mbarështojnë 10-30 krerë buallica.".

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Sali Berisha**

Copyright 2012 - www.ligjet.org